

**L I G J**  
**Nr.8453, datë 4.2.1999**

**PËR DISA PLOTËSIME NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 “PËR URBANISTIKËN”,  
BAZUAR NË VENDIMIN NR.2, DATË 25.1.1999 TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Duke u bazuar në vendimin nr.2, datë 25.1.1999 të Gjykatës Kushtetuese, me anë të së cilës Gjykata Kushtetuese shfuqizoi si antikushtetues paragrafin e fundit të nenit 14 dhe paragrafin e parë dhe të tretë të nenit 23 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 14 paragrafi i parë riformulohet si vijon:

“Organet e specializuara për urbanistikën pranë/në pushtetin lokal janë:”

Si paragraf i fundit i nenit 14 bëhet formulimi i mëposhtëm:

“Ngritja e KRRT-ve bëhet në mënyrën dhe përbërjen e parashikuar me këtë ligj, ku çdo subjekt i paraqet kryetarit të rrethit (bashkisë) përfaqësuesit e vet. Mbledhja e parë e KRRT-së thirret brenda 10 ditëve nga çasti kur pranë tij janë paraqitur më shumë se 2/3 e përfaqësuesve të subjekteve të parashikaura me këtë ligj. Anëtarët e KRRT-së shpërblehen për punën e tyre. Shpërblymi përcaktohet me akte nënligjore.

**Neni 2**

Si paragraf i parë i nenit 23 bëhet formulimi i mëposhtëm:

“Emërimi dhe shkarkimi i përgjegjësit të seksionit të urbanistikës në këshillat e rretheve, këshillat e bashkive të qyteteve të kategorisë së parë dhe i Drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, bëhet sipas ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin e funksionimin e pushtetit lokal”.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2313, datë 11.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**